



VENDIM

Nr. 91, Datë 09.06.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË
“GAVRAN ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “GAVRAN 1” ME FUQI TE
INSTALUAR 998 KW DHE “GAVRAN“ ME FUQI TE INSTALUAR 1215
KW, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 2213 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5, pika 1 gërma ‘g’; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gavran Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.3 gërmat “a”, “b”; 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.5 gërmat “a”, “b” “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Paraqitjen e strukturës administrative të shoqërisë (neni 9 pika 2 gërma “e”),
- Paraqitjen e dokumentave që vërtetojnë mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9 pika 3 gërma “c”),
- Të dhënat për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin (neni 9 pikat 4.1.1 dhe 4.1.2),
- Shtrirjen e vendit ku do të zhvillohet veprimtaria dhe harta topografike, ku të paraqitet gjurma e linjës transmetuese, (neni 9 pika 4.1.3 gërmat “c” dhe “d”), do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesëhëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Gavran Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Gavran 1” me fuqi 998 KW dhe “Gavran” me fuqi 1215 KW, me fuqi totale të instaluar 2213 KW.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI